



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 03.09.2019

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT, PËR TRANSPORTIN DETAR”

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 03.09.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Katarit, për transportin detar”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin z. Jurgis Çyrbja.

Në mbledhjen e komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit, ishte i pranishëm z. Artan Shkreli, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit, për transportin detar.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje synon forcimin e marrëdhënieve ndërmjet të dyja vendeve në fushën e transportit detar, në bazë të parimeve të lundrimit të lirë, duke marrë parasysh parimet e barazisë, të bashkëpunimit dhe të përfitimeve të ndërsjella. Marrëveshja bazohet në konventën e Kombeve të Bashkuara për ligjin e detit si dhe në konventa të tjera ndërkombëtare, për sigurinë e transportit detar, lehtësimin e transportit detar ndërkombëtar, kushtet e jetës dhe të punës së detarëve, transportin e mallrave të rrezikshme dhe mbrojtjen e mjedisit detar.

Marrëveshja përbëhet nga 16 nene të cilat, bazuar në të drejtën ndërkombëtare si dhe në kuadrin ligjor kombëtar të secilit shtet, parashikojnë lirinë e trafikut dhe mosdiskriminimin, trajtimin në mënyrë të barabartë të mjeteve lundruese të palëve, masat që duhet të ndërmarrin shtetet palë për lehtësimin e transportit detar, dokumentet e nevojshme të anijes, të drejtën e njëjës palë që të vendosë përfaqësim në territorin e shtetit tjetër, shmangien e taksimit të dyfishtë, angazhimin palëve për asistencë gjatë incidenteve në shtetet e tyre përkatëse, njohjen e dokumentit të udhëtimit të ekuipazhit të anijeve të lëshuara nga administratat detare respektive, juridiksionin ligjor që zbatohet brenda anijes etj, duke inkurajuar shtetet palë të marrëveshjes për të kryer transport ndërkombëtar detar ndërmjet të dyja vendeve

Hyrja në fuqi e marrëveshjes parashikohet të jetë në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të të cilit palët njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e të gjitha procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja do të jetë e vlefshme për 3 vjet si dhe do të rinovohet automatikisht për një periudhë apo periudha të tjera të ngjashme, duke mbetur në fuqi derisa njëra nga palët kontraktuese të njoftojë palën tjetër me shkrim se kërkon të përfundojë këtë marrëveshje.

III. DISKUTIME NË KOMISION

Relatori, z. Çyrbja gjeti rastin të përmendte përpara anëtarëve të komisionit vizitën në territorin shqiptar të anijes me vela “Fateh Al Khair 4”, një vizitë unike në llojin e vet, që synoi prezantimin e trashëgimisë detare, kulturës dhe traditës së Katarit dhe promovimin e Botërorit të Futbollit Katar 2022. Kjo vizitë i parapriu ratifikimit të kësaj marrëveshjeje si një tjetër dëshmi e miqësisë së mirë që ekziston mes dy popujve tanë. Z. Çyrbja ftoi të gjithë anëtarët e komisionit ta votojnë projektligjin, duke kontribuar në zhvillimin e marrëdhënieve të përbashkëta ekonomike dhe tregtare ndërmjet të dyja vendeve.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATOR

KRYETAR

JURGIS ÇYRBJA

ULSI MANJA